

**Akt Themelimi**  
I shoqërisë tregtare “M-S SECURITY“ shpk

Sot me date 05/11/2024, mbështetur ne Kushtetuten e Shqipërisë dhe Kodin Civil ne fuqi te Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr 9901 datë 14.04.2008 “ Për shoqëritë tregtare” dhe të ligjit nr 9723 datë 03.05.2007 “ Për Q.K.R. dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare” më vullnetin e tyre të lirë të shprehur edhe me nënshkrimin e këtij akt themelimi nga ortakët:

- 1- **Melton Blakaj**, i biri i Islami-it, i datëlindjes 30.04.1979 lindur në Tiranë , banues në Tiranë, Rr.Ylbere Bylykbashi nr 25/3, shtetas shqiptar, madhor me zotësi juridike për të vepruar.

**Formulimi**

Neni 1

Formohet shoqëria tregtare private e quajtur “ M-S SECURITY” shpk

Shoqëria do ti nënshtrohet legjisacionit shqiptar. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues.

**Selia e Shoqërisë**

Neni 2

Selia e shoqërisë tregtare private “M-S SECURITY” shpk do të jetë në **Zona Kadastrale Nr.3866. Numri Pasurise 368/35-G49 Tiranë**.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyrë përfaqsie, degë , të krijojë filiale si brenda ,ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë,vetëm me vendim të ansamblesë dhe ortakëve.

**Objekti i veprimtarisë**

Neni 3

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushat e mëposhtme:

- “Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private, i personave, si dhe veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare e politike”, e cila ushtrohet në të gjithë territorin e vendit. Veprimtari të ruajtjes e sigurisë fizike si SHPSF duke ofruar sigurimin fizik të objekteve shtetërore e private, i personave, si dhe veprimtarive social kulturore,sportive,fetare e politike Në të gjithe territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Ofroj I zgjidhjeve të integruar të sigurisë dhe menaxhimit të objekteve, instalimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve fizike të sigurisë, ruajtjen dhe manipulimin e sigurt të të dhënave, zhvillimin e softuerit të personalizuar, teknologjite kundër vjedhjeve dhe shërbimet e menaxhimit të plotë të objekteve. Mbrojtja aseteve, për të optimizuar efikasitetin operativ dhe për të forcuar masat e sigurisë për klientët në industri të ndryshme.
- Shitje brenda dhe jashtë vendit te produkteve industrial,kozmetike dhe parafarmaceutike fizikisht dhe online permes platformave dixhitale.
- Studimi projektimi dhe realizimin e reklamave/publicitetit dhe fushatave publicitare ne per gjithsi për vete e për të tretë, duke e ushtruar këtë aktivitet pa kushtëzuar mjetet dhe mënyrat përvç atyre të ndaluara me ligj.
- Shërbim teknologji informacioni, Web-i,dixhital marketing, google ads, social network distribution, dhe



tregtim të sistemeve të teknologjise së informacionit për përpunimin e të dhënave të të gjitha llojeve si : hardware, softwer,,networking dhe gjithe periferikeve të tyre. Website,Radioweb dhe të gjithë veprimtaritë e masmedias së zhvilluar përmes internetit.

- Botimi i librave, revistave,të përditshmeve dhe periodikëve në përputhje dhe respekt të legjislacionit në fuqi.
- Printime dixhitale, offset në material të ndryshme, për qëllime artistike dhe në mbështetje të aktiviteteve të përshkruara në pikat e mësiperme të veprimtarisë .
- Veprimtari në fushën e turizmit dhe imobiliare,leshim biletash elektronike udhëtimi etj.

### **Kohëzgjatja e shoqërisë**

Neni 4

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pakufizuar.Ajo mund të shpërbëhet ne çdo kohë dhe për çfarë do lloj shkaku.

### **Kapitali i Shoqërisë**

Neni 5

Kapitali fillestar i shoqërisë “ M-S SECURITY” shpk do të jetë 1 000 000(një milion) lekë.Kapitali është i ndarë në 1 kuota të zotëruara 100% nga ortaku i vetëm dhe themeluesi i shoqërisë.

Kuotat e kapitalit të shoqërisë mund të shiten lirisht me vendim të ansamblesë së ortakëve.

Kapitali themeltar fillestar mund të shtohet ose pakësohet(por jo nën vlerën e kapitalit fillestar).

### **Drejtimi Shoqërisë**

Neni 6

Shoqëria do të drejtohet nga administratori dhe përfaquesi ligjor i saj.Ai është përfaques i shoqërisë në marrëdhënie me të tretët dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj.

Cdo kontratë do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga një përfaques i pajisur me prokurë të posaçme.

Neni 7

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakëve të shoqërisë të cilat ndahen në proporcion me kuotat e zotëruara prej çdonjërit prej ortakëve.

Neni 8

Konfliktet që mund të lindin zgjidhen në zbatim të legjislacionit shqiptar.

Neni 9

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me logon dhe tekstin brënda saj.

Neni 10

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin



shqiptar në fuqi e vecanërisht të ligjit nr 9901, datë 14.04.2008 “ Për krijimin e Shoqërive Tregtare”, si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare e të vendit, si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryhen kjo shoqëri.

Çështjet që nuk trajtohen në këtë akt themelimi trajtohen, rregullohen në statutin e Shoqërisë si dhe lëgjislacionin përkatës shqiptar.

Neni 11

Akti i themelimit u përpilua në 5 kopje, për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë “M-S SECURITY” shpk.

Akti i themelimit u nënshkrua rregullisht nga ortakët e shoqërisë.

Ortakët e Shoqërisë

**“ M-S SECURITY” shpk**

Melton Blakaj

